



ZYRA E MBROJTJES NDËRKOMBËTARE

Broshurë informuese për fëmijët e pashoqëruar/individualë të cilët janë aplikues për mbrojtje ndërkombëtare

JU LUTEMI TA LEXONI TË GJITHË INFORMACIONIN NË KËTË BROSHURË

Kjo broshurë është për informimin e fëmijëve (nën moshën 18 vjeç) që aplikojnë për mbrojtje ndërkombëtare pa prindin ose kujdestarin ligjor.

Shënime të rëndësishme

Ligjet mbi aplikimet për mbrojtje ndërkombëtare në Irlandë përshkruhen kryesisht tek Akti i Mbrojtjes Ndërkombëtare 2015. Mund ta lexoni Aktin 2015 të plotë në faqen e internetit www.ipo.gov.ie

Kjo broshurë është vetëm për informim dhe udhëzim. Kjo broshurë nuk është udhëzues ligjor për Aktin e Mbrojtjes Ndërkombëtare 2015.

Përmbajtja

1. Rreth kësaj broshure
 2. Kush do të më ndihmojë?
 3. Procesi fillestar i aplikimit
 4. Çfarë bën një interpret?
 5. Intervista paraprake
 6. Fotografi dhe gjurmët e gishtërinjve
 7. A mund të më dërgojnë në shtet tjetër?
 8. Rregullorja e Dublinit
 9. Çfarë është identiteti?
 10. Vlerësimi i moshës
 11. Intervista e vlerësimit të moshës
 12. Pasi të jetë kryer intervista, çfarë ndodh më pas?
 13. Pyetëtori
 14. Intervista kryesore
 15. Raporti mbi shqyrtimin e aplikimit tuaj
 16. Rekomandimi
 17. Çfarë ndodh nëse më akordohet Mbrojtja Ndërkombëtare?
 18. Çfarë ndodh nëse më refuzohet Mbrojtja Ndërkombëtare?
 19. Organizatat me të cilat hyn në kontakt
 20. Më shumë informacion
 21. Numra telefoni dhe adresa email të rëndësishme
-

1. Rreth kësaj broshure

Përshëndetjel! Kjo broshurë është për fëmijët/të miturit individualë që kanë mbërritur pa prindërit ose kujdestarin dhe kanë aplikuar nëpërmjet TUSLA - Agjencia e Fëmijës dhe Familjes për mbrojtje ndërkombëtare në Irlandë me kusht që TUSLA të sugjerojë se është në interesin më të mirë të të miturit individual të bëjë këtë aplikim. Nëse bëhet ky aplikim do të merret në shqyrtim nga personeli i zyrës së njohur si Zyra e Mbrojtjes Ndërkombëtare.

Fëmijët individualë janë fëmijët nën moshën 18 vjeç që ndodhen jashtë vendit të tyre të origjinës dhe janë të ndarë si nga prindërit edhe nga kujdestarët ligjorë/mbrojtësit kryesorë fillestarë.

Kjo broshurë përshkruan çfarë është mbrojtja ndërkombëtare dhe fazat e ndryshme të aplikimit për mbrojtje ndërkombëtare.

Duhet ta lexoni këtë broshurë nga faqja e parë deri tek e fundit dhe të mësoni çfarë ndodh pasi TUSLA të ketë bërë një aplikim për mbrojtje ndërkombëtare në emrin tuaj.

Duhet ta ruani këtë broshurë pasi mund të jetë e dobishme për ju gjatë kohës si aplikues për mbrojtje ndërkombëtare në Irlandë. Gjithashtu ka një faqe ku mund të ruani numrat e dobishëm të telefonit dhe adresat email.

Gjithashtu duhet të lexoni Broshurën e Informacionit për Aplikantët për Mbrojtje Ndërkombëtare. Nëse ju nevojitet ndihmë për të kuptuar diçka në të, duhet ta kërkonit nga përfaqësuesi juaj i TUSLA-s i cili mund të kërkojë konsulencë apo ndihmë ligjore të mëtejshme.

2. Kush do të më ndihmojë

Për arsye se jeni 18 vjeç, në Irlandë juve nuk ju lejohet të merrni disa vendime më vete. Duhet ta bëni këtë bashkë me dikë që është përgjegjës për ju dhe i cili ju ndihmon të merrni këto vendime.

Nëse vini te Zyra e Mbrojtjes Ndërkombëtare ose mbërrini në pika kufitare të Irlandës për të kërkuar Mbrojtje Ndërkombëtare dhe kur vlerësohet se jeni fëmijë nën moshën 18 vjeç, si dhe jeni pa kujdestarinë e një të rrituri përkatës do të referoheni tek TUSLA.

Ekipi i Fëmijëve Individualë në TUSLA është përgjegjës për kujdesin dhe mirëqenien e personave nën moshën 18 vjeç në këtë shtet. Juve do t'ju caktohet një përfaqësues nga TUSLA (punonjës social ose kujdestar) i cili do t'ju ndihmojë. Për ju do të krijohet një plan kujdesi nga TUSLA. Mund të diskutoni çdo gjë në lidhje me qëndrimin tuaj në Irlandë me këtë person.

Pasi të referoheni te TUSLA, TUSLA ndërmerr rolin e kujdesit për mirëqenien tuaj të përgjithshme. TUSLA mund t'ju ribashkojë me anëtarët e tjerë të familjes tuaj në IRLANDË (nëse është e përshtatshme).

Gjithashtu TUSLA do të vendos nëse është në interesin tuaj më të mirë të bëni aplikim për mbrojtje ndërkombëtare. TUSLA nuk do ta bëjë këtë aplikim nëse nuk është e bindur se është në interesin tuaj më të mirë ta bëjë këtë aplikim. Është e rëndësishme që të jeni i sigurtë me TUSLA-n rreth situatës tuaj në mënyrë që të mund të marrin vendim të bazuar në informacionin më të mirë të mundshëm, duke përfshirë këshillimin ligjor.

3. Procesi fillestar i aplikimit

Nëse TUSLA vendos se është në interesin tuaj më të mirë të bëni një aplikim për mbrojtje ndërkombëtare ata do të kontaktojnë Bordin e Ndhmës Ligjore i cili do të mundësojë këshillim ligjor dhe asistencë në lidhje me aplikimin tuaj për mbrojtje ndërkombëtare dhe gjithashtu do t'ju ndihmojë gjatë procesit të mbrojtjes.

Gjithashtu TUSLA do të caktojë një datë dhe orar takimi me Njësinë Pritëse të Zyrës së Mbrojtjes Ndërkombëtare për të bërë aplikimin tuaj.

Aplikimi ndërkombëtar për mbrojtje duhet të bëhet personalisht te International Protection Office of the Irish Naturalisation and Immigration Service, në adresën 79-83 Lower Mount Street, Dublin 2. Gjithashtu kjo zyrë do të përpunojë aplikimin tuaj.



(Hyrja kryesore IPO)

Ju do të shoqëroheni në këtë zyrë nga përfaqësuesi juaj TUSLA. TUSLA do të bëjë aplikimin ndërkombëtar për mbrojtje në emrin tuaj.

Nëse ju nevojitet në interpret për t'ju ndihmuar në komunikimin me ne do t'ju mundësojmë.

4. Çfarë bën një interpret?

Në mënyrë që ju dhe personeli te Zyra e Mbrojtjes Ndërkombëtare të mund të kuptoni njëri-tjetrin, një interpret do të përkthejë çfarë thuhet. Interpreti mund të flasë gjuhën angleze dhe gjuhën që flisni ju. Zakonisht interpreti ndodhet në të njëjtën dhomë me ju. Nëpërmjet interpretit, personeli i pritjes dhe ju mund të komunikoni me njëri-tjetrin. Interpreti do të përkthejë vetëm çfarë thuhet. Interpretit nuk i lejohet ta diskutojë çështjen ose të dhënat personale tuaja me askënd, kështu që mund t'i tregoni historinë tuaj me siguri dhe në mirëbesim.



(Hyrja në pritje)

5. Intervista paraprake

Njësia e Pritjes në Zyrën Ndërkombëtare të Mbrojtjes është përgjegjëse për marrjen e aplikimeve nga njerëzit që po aplikojnë për mbrojtje ndërkombëtare. Do të kryeni intervistën paraprake në mënyrë private me personelin e Njesisë së Pritjes ku do ti përgjigjeni pyetjeve rreth

- kush është emri juaj,
- kur dhe ku keni lindur,
- familja juaj,
- adresa dhe detajet e prindërve tuaj,
- nga jeni,
- cilat gjuhë flisni,
- si keni udhëtuar drejt Irlandës,
- përse jeni larguar nga vendi juaj.

Intervista juaj paraprake do të shqyrtojë gjithashtu nëse Zyra e Mbrojtjes Ndërkombëtare mund ta pranojë aplikimin tuaj për mbrojtje. Kjo njihet si procesi i pranueshmërisë.



(Zona kryesore e pritjes)

Personeli i Njesisë së Pritjes do t'ju bëjë këto pyetje në mënyrë që t'ju regjistrojë në bazën kompjuterike të të dhënave të Zyrës së Mbrojtjes Ndërkombëtare.



(Dhoma e intervistës fillestare)

Ka rëndësi që Zyra e Mbrojtjes Ndërkombëtare të vihet në dijeni të arsyeve përse nuk mund të qëndroni në vendin tuaj dhe si ndiheni që nga arritja juaj në Irlandë.

Siç është përmendur më herët, pas Intervistës Paraprake, përgjithësisht TUSLA bën aplikimin për Mbrojtje Ndërkombëtare në emrin tuaj kështu që duhet të konsiderohet se është në interesin më të mirë tuaj për ta bërë këtë.

6. Fotografi dhe gjurmët e gishtërinjve

Si pjesë e procesit të ekzaminimit, juve do t'ju kërkohet t'ju bëhet fotografi. Gjithashtu do t'ju kërkohet t'ju merren shenjat e gishtërinjve nëse jeni **mbi 14 vjeç**. Ju do të pajiseni me një Certifikatë Qëndrimi të Përkohshme (TRC). Në të do të ketë detajet personale tuaja dhe do të përmbajë fotografinë tuaj. Megjithëse TRC duket si kartë identiteti, nuk është një dokument zyrtar identiteti. Ju mundëson të qëndroni në Irlandë gjatë shqyrtimit të aplikimit tuaj. Duhet ta ruani këtë kartë.

Përse Zyra e Mbrojtjes Ndërkombëtare merr shenjat e gishtërinjve?

Zyra i merr shenjat e gishtërinjve për të kontrolluar nëse keni aplikuar më parë në Irlandë ose në ndonjë vend evropian. Nëse jeni mbi moshën 14 vjeçare, personeli i Njësisë së Pritjes do t'ju marrë shenjat e gishtërinjve.

Si merren shenjat e gishtërinjve?

Shenjat e gishtërinjve merren kur gishtat puthiten në një makineri që lexon shenjat e gishtërinjve.



(Makineria e shenjave të gishtërinjve)

Çfarë bën Zyra e Mbrojtjes Ndërkombëtare me shenjat e gishtërinjve?

Shenjat e gishtërinjve dërgohen në disa baza të dhënash. Njëra prej tyre ndodhet në Irlandë. Në këtë bazë të dhënash Zyra mund të kontrollojë nëse keni aplikuar më parë për mbrojtje në Irlandë.

Bashkimi Evropian (BE) ka një bazë tjetër të dhënash që quhet Eurodac. Të gjitha 28 shtetet plus Islanda, Norvegjia dhe Zvicra kanë qasje te kjo bazë të dhënash dhe mund ta kontrollojnë atë.

Këto shtete janë pjesë e "procesit të Dublinit" i cili ka marrë emrin pas traktatit të azilkërkimit që u nënshkrua në Dublin.

Nëse keni aplikuar për mbrojtje në ndonjë prej këtyre shteteve më parë, do të shfaqet në bazën e të dhënave Eurodac.

7. A mund të më dërgojnë në shtet tjetër?

Nëse keni aplikuar për mbrojtje ndërkombëtare në ndonjë shtet tjetër pjesëmarrës në procesin e Dublinit, ai shtet mund të jetë përgjegjës për trajtimin e aplikimit tuaj. Në këtë rast, Zyra e Mbrojtjes Ndërkombëtare në Irlandë mund të mos e përpunojë më tej aplikimin tuaj dhe ju mund të dërgoheni mbrapsht në vendin ku keni aplikuar fillimisht për mbrojtje ndërkombëtare nëse është në interesin tuaj më të mirë.

Gjatë kësaj procedure ne gjithmonë do të veprojmë sipas interesave tuaja më të mira dhe nuk do t'ju dërgojmë në një shtet ku është përcaktuar se të drejtat tuaja njerëzore mund të shkelen. Gjithashtu mund të zgjedhim ta shqyrtojmë aplikimin tuaj në këtë vend, megjithëse sipas ligjit një shtet tjetër mund të jetë përgjegjës për ta bërë. Mund ta bëjmë këtë për arsye humanitare, familjare ose kulturore.

8. Rregullorja e Dublinit

Çfarë është Rregullorja e Dublinit?

Në 28 shtetet e BE-së (Austri, Belgjikë, Bullgari, Kroaci, Qipro, Republika Çeke, Danimarkë, Estoni, Finlandë, Francë, Gjermani, Greqi, Hungari, Irlandë, Itali, Letoni, Lituani, Luksemburg, Maltë, Holandë, Poloni, Portugali, Rumani, Sllovaki, Slloveni, Spanjë, Suedi dhe Mbretëria e Bashkuar) plus Norvegji, Islandë dhe Zvicër ka rregulla që përcaktojnë shtetin përgjegjës për përpunimin e aplikimit tuaj për mbrojtje. Rregullat thonë se vetëm një shtet e merr në shqyrtim aplikimin.

Këto rregulla quhen Rregullorja e Dublinit dhe zbatohen si ligj në të gjitha këto shtete. Nëse keni qenë në një shtet tjetër ku zbatohet kjo rregullore para se të vinit në Irlandë duhet të shkoni përsëri atje. Kjo mund të zbatohet në rastet vijuese

- keni aplikuar tashmë për mbrojtje ndërkombëtare në një shtet tjetër ku zbatohet Rregullorja e Dublinit,
- prindërit/kujdestari juaj po jeton në mënyrë të ligjshme në një vend tjetër ku zbatohet kjo rregullore,
- keni kushërinj në një shtet tjetër ku zbatohet Rregullorja e Dublinit që mund të kujdesen për ju aty.

Çfarë ndodh nëse një shtet tjetër që zbaton Rregulloren e Dublinit e merr në shqyrtim aplikimin tim për mbrojtje ndërkombëtare?

Atëherë ju dhe përfaqësuesi juaj TUSLA do të konsultoheni mbi këtë nga personeli në Zyrën Ndërkombëtare të Mbrojtjes. Do të merrni informacion për vendimin e bazuar mbi Rregulloren e Dublinit nëse një shtet tjetër mund të bëhet ose është bërë përgjegjës për shqyrtimin e aplikimit. Gjithashtu keni mundësinë të jepni arsyen përse nuk duhet të shkoni në këtë shtet ku zbatohet Rregullorja e Dublinit. Mund të thoni pse dëshironi që aplikimi të shqyrtohet në Irlandë. Përfaqësuesi juaj i TUSLA do t'ju ndihmojë në këtë proces.

A mund të apeloj një vendim të procesit të Dublinit?

Nëse nuk jeni i kënaqur me vendimin e Zyrës së Mbrojtjes Ndërkombëtare keni të drejtë ta apelon vendimin te Gjykata e Apelit të Mbrojtjes Ndërkombëtare (IPAT). Gjykata nuk do të rishikojë përse keni aplikuar për mbrojtje ndërkombëtare. Do të vendosë vetëm se cili shtet duhet ta marrë në shqyrtim aplikimin tuaj për mbrojtje ndërkombëtare. Ju lutemi të lexoni broshurën shtesë të informacionit mbi procesin e Dublinit që ju është dhënë.

9. Çfarë është identiteti?

Identiteti përmban detaje mbi personin tuaj, emrin tuaj, ku keni lindur, nga vini dhe kush janë prindërit dhe kujdestarët tuaj.

Përse duhet të provoj se kush jam?

Zyra e Mbrojtjes Ndërkombëtare dëshiron të dijë se kush jeni dhe nga vini për të qenë në gjendje të marrë vendimin e duhur në lidhje me aplikimin tuaj për mbrojtje. Është përgjegjësia juaj të tregoni emrin tuaj dhe nga vini. Mënyra më e mirë për të treguar identitetin tuaj është duke shfaqur pasaportën ose kartën e identitetit. Nëse nuk mund të tregoni se kush jeni do të jetë më e vështirë për Zyrën Ndërkombëtare të Mbrojtjes që të vlerësojë nëse keni të drejtë për mbrojtje ndërkombëtare ose jo.



10. Vlerësimi i moshës

Kur ka dyshim rreth moshës tuaj, Zyrës së Mbrojtjes Ndërkombëtare mund t'i duhet të kryejë një vlerësim të moshës. Zyra e Mbrojtjes Ndërkombëtare shpesh drejtohet në këtë vlerësim moshe nga personeli i TUSLA-s.

Çfarë është një vlerësim moshe?

Në këtë proces, vlerësimi i moshës është një opinion i informuar mbi moshën e një personi. Zyra e Mbrojtjes Ndërkombëtare mund të vlerësojë moshën tuaj nëse nuk mund të tregoni se sa vjeç jeni dhe nëse moshja juaj nuk duket se është e saktë.

Përse është e rëndësishme që të tregoj moshën time?

Nëse nuk keni dokumente identifikimi dhe nuk mund ta tregoni moshën tuaj në ndonjë mënyrë tjetër dhe moshja juaj nuk duket se është e saktë, personi i Njësisë së Pritjes në Zyrën Ndërkombëtare të Mbrojtjes duhet të zhvillojë një bisede më ju për të gjetur se sa vjeç jeni. Kjo do të thotë se një anëtar i personelit do të flasë me ju për të gjetur sa vjeç jeni.

11. Intervista e vlerësimit të moshës

Intervista e vlerësimit të moshës është krijuar për të zbuluar disa fakte kryesore rreth udhëtimit tuaj, vendndodhjen e prindërve/kujdestarëve tuaj, standardin tuaj të arsimit dhe nivelin e pjekurisë. Anëtar i personelit në Njësinë e Pritjes më pas do të vendosë nëse ata mendojnë se ju jeni nën moshën 18 vjeç. Nëse vendoset jeni nën moshën 18 vjeç do të referoheni te TUSLA.

12. Pasi të jetë kryer intervista, çfarë ndodh më pas?

Ju duhet të bashkëpunoni me Zyrën Ndërkombëtare të Mbrojtjes gjatë procesit të aplikimit për mbrojtje.

Zyra e Mbrojtjes Ndërkombëtare do të marrë nën shqyrtim aplikimin tuaj për llogari të Ministrit të Drejtësisë dhe Barazisë dhe do të vendosë nëse kualifikoheni për mbrojtje ndërkombëtare ose nëse ka arsye të tjera që ju mundësojnë të qëndroni në Irlandë.

Kjo është arsyeja përse Zyra e Mbrojtjes Ndërkombëtare duhet të shqyrtojë identitetin, kombësinë, udhëtimin tuaj, nëse keni qëndruar në ndonjë shtet tjetër dhe arsyet tuaja për aplikim për mbrojtje ndërkombëtare në Irlandë.

Për të mund ta bërë këtë në mënyrën e duhur, duhet t'i jepni personelit në Zyrën Ndërkombëtare të Mbrojtjes të gjitha dokumentet dhe letrat që ndihmojnë për identitetin tuaj dhe nga vini. Ju lutemi të na jepni dokumente të tjera që mund të keni të cilat kanë lidhje me aplikimin.

Ka shumë rëndësi që të na tregoni të vërtetën gjatë përpunimit të aplikimit tuaj për mbrojtje ndërkombëtare. Nëse fshihni informacion ose nuk tregoni të gjithë të vërtetën mund të mos ju jepet mbrojtje ndërkombëtare ose mund të mos ju lejohet të qëndroni në Irlandë.

Nëse nuk bashkëpunoni me shqyrtimin e aplikimit tuaj atëherë aplikimi juaj mund të vendoset në bazë të informacionit aktual të ruajtur në skedar deri në atë moment.

Gjithashtu keni të drejtë për konsulencë ligjore nga Bordi i Ndihmës Ligjore kur jeni në procesin e mbrojtjes dhe përfaqësuesi juaj TUSLA do të marrë masa ligjore për këtë shërbim.

13. Pyetësoni

Juve do t'ju jepet një pyetëson të cilin duhet ta plotësoni dhe ta dërgoni te Zyra e Mbrojtjes Ndërkombëtare deri në një datë të caktuar. Përfaqësuesi juaj i TUSLA-s do t'ju ndihmojë të plotësoni pyetësonin dhe ta dërgoni te Zyra e Mbrojtjes Ndërkombëtare në zarfin e postës të parapaguar nga zyra.

Informacioni që plotësoni në pyetëson do të shqyrtohet gjatë vlerësimit të aplikimit tuaj për mbrojtje ndërkombëtare dhe arsye të tjera përse dëshironi të qëndroni në Irlandë. Ka shumë rëndësi që në pyetëson të jepni të gjitha arsyet përse kërkonte mbrojtje ndërkombëtare dhe të gjitha arsyet përse nuk mund të ktheheni në shtëpi dhe dëshironi të qëndroni në Irlandë.

Ju lutemi të kini parasysh se duhet t'i përgjigjeni të gjitha pyetjeve me vërtetësi në mënyrë që të kemi të gjithë informacionin më të mirë të mundshëm.



(Zona e pritjes për intervistë)

14. Intervista kryesore.

Procesi i mbrojtjes ndërkombëtare zakonisht kërkon që të jeni i pranishëm gjatë intervistës kryesore. Ju dhe TUSLA do të informoheni me shkrim për orën, datën dhe vendin ku do të zhvillohet intervista në lidhje me aplikimin tuaj për mbrojtje. Qëllimi i kësaj interviste është përcaktimi i detajeve të plota të kërkesës tuaj për mbrojtje ndërkombëtare në Irlandë.

Një grup intervistuesish me eksperiencë në Zyrën Ndërkombëtare të Mbrojtjes kanë marrë trajnim shtesë të specializuar për t'i ndihmuar gjatë punës mbi rastet me aplikantë si ju (të miturit/fëmijët individualë të pashoqëruar). Intervistuesi juaj do të trajnohet veçanërisht për intervistimin e fëmijëve nën moshën 18 vjeç.



(Dhoma e intervistës fillestare)

Është e rëndësishme që të na tregoni çdo gjë që ju ka ndodhur dhe përse nuk mund të ktheheni në shtëpi. Ka rëndësi që intervistuesit të vihet në dijeni të arsyeve përse nuk mund të qëndroni në vendin tuaj. Do të regjistrohet historia juaj. Regjistrimi janë praktikisht shënimet rreth çfarë keni thënë gjatë intervistës. Do ta lexoni regjistrimin me përfaqësuesin e TUSLA-s dhe do të pranoni regjistrimin me intervistuesin duke nënshkruar në fund të çdo faqeje.

Nëse ka gabime është e rëndësishme që të korrigjohen në ditën e intervistës - në të kundërt do të jetë e vështirë ta bëni më vonë.

Zakonisht intervista kërkon 2 deri në 3 orë për të përfunduar por mos u shqetësoni, do të ketë pushime të rregullta. Nëse ju nevojitet një pushim për ndonjë arsye ose nëse mërzhiteni, mos u shqetësoni, mund t'i kërkonti intervistuesit t'ju japë kohën që ju nevojitet.

Pasi të ketë përfunduar intervista juaj, i gjithë informacioni i mbledhur nga aplikimi, pyetësi, intervistat dhe ndonjë dokumentacion i dërguar nga ju ose për llogari tuaj do të shqyrtohet para se të përgatitet raporti mbi aplikimin tuaj.

15. Raporti mbi shqyrtimin e aplikimit tuaj

Një raport do të përgatitet nga Zyra e Mbrojtjes Ndërkombëtare mbi rezultatet e shqyrtimit të aplikimit tuaj i cili përfshin një rekomandim dhe zbulimet nëse keni të drejtë për mbrojtje ndërkombëtare ose nëse ka arsye të tjera që t'ju akordohet leje qëndrimi në Irlandë.

Raporti do t'i referohet çështjeve të rëndësishme për aplikimin tuaj duke përfshirë formularin e aplikimit, pyetësonin dhe çdo çështje që është ngritur gjatë intervistës. Gjithashtu mund të marrë parasysh ndonjë përfaqësim të bërë për llogarinë tuaj nga TUSLA, përfaqësuesit juaj ligjor ose ndonjë person tjetër.

16. Rekomandimi

Zyra e Mbrojtjes Ndërkombëtare do të shqyrtojë aplikimin tuaj për mbrojtje ndërkombëtare dhe do të bëjë rekomandim nëse:

- (1) Keni të drejtë për status refugjati:
- (2) Keni të drejtë për mbrojtje shtesë:
- (3) ose nëse ka arsye të tjera përse duhet t'ju lejohet qëndrimi në Irlandë.

(1) Statusi i refugjatit

Një person që i mund të jetë objekt persekutimi nëse kthehen në vendin e tyre mund të qëndrojë në Irlandë si refugjat. Për tu akorduar statusi i refugjatit, një aplikant duhet t'i frikësohet persekutimit për një prej pesë arsyeve dhe të jetë kaq i frikësuar sa që ai ose ajo nuk mund apo nuk mund të përdorë mbrojtjen nga shteti në vendin e tij ose të saj, për shembull mbrojtjen policore.

5 arsyt

- raca (origjina), që është origjina kombëtare ose etnike (për shembull ngjyra e lëkurës).
- kombësia, për shembull grupi gjuhësor ose etnik.
- feja.
- opinioni politik (opinione mbi mënyrën si duhet të qeveriset një vend).
- përkatësia në një grup social të caktuar, gjinia (vajzë ose djalë) apo orientimi seksual (orientimi seksual do të thotë nëse një person bie në dashuri me vajzat, djemtë ose si djemtë dhe vajzat).

Mbrojtja e refugjatit zbatohet pavarësisht nëse persekutimi bëhet nga autoritet e vendit ose nëse autoritetet e vendit nuk mund apo nuk të ofrojnë mbrojtje nga persekutimi.

(2) Personat e pranueshëm për mbrojtje shtesë

Personat në nevojë për mbrojtje shtesë janë persona që nuk janë refugjatë sipas përkufizimit ligjor por të cilët kanë frikë të kthehen në vendin e tyre.

Ka tre arsye kryesore përse një person ka nevojë për mbrojtje shtesë dhe nuk mund të kthehet në vendin e tij. Personi -

1. rrezikon torturën ose ndëshkimin me vdekje atje.
2. mund të përballet me trajtim çnjerëzor ose degradues nëse ai ose ajo kthehet.
3. ka nevojë për mbrojtje sepse ka rrezik serioz që ai ose ajo do të lëndohen në luftë ose dhunë tjetër në atë vend.

Ju mund të keni nevojë për mbrojtje nëse nuk mund të merrni mbrojtje dhe ndihmë në vendin tuaj nga autoritetet atje.

(3) Leje për të qëndruar.

Varet nga ju dhe nga përfaqësuesi juaj TUSLA për të parashtruar arsyet me shkrim për të kërkuar leje qëndrimi në Irlandë kur plotësoni Pyetësonin e Mbrojtjes Ndërkombëtare. Duhet ta mbani Zyrën Ndërkombëtare të Mbrojtjes të informuar mbi ndryshimet në rrethanat tuaja në këtë aspekt.

Zyra e Mbrojtjes Ndërkombëtare do të vlerësojë aplikimin tuaj për llogari të ministrit, duke marrë parasysh rrethanat familjare dhe personale, si dhe të drejtën dhe respektin tuaj për jetën private dhe familjare, duke pasur parasysh

- natyrën e lidhjes tuaj me shtetin (Irlandën), nëse ka,
- konsiderata humanitare,
- karakterin tuaj dhe sjelljen si brenda dhe jashtë shtetit (Irlandës), (duke përfshirë dënimet penale),
- rrethanat e sigurisë kombëtare dhe rendit publik dhe
- ndonjë rrethanë tjetër për të mirën e përbashkët.

Ministri do të ketë parasysh edhe çështjet e ngritura prej jush rreth ndalimit të riatdhesimit.

Riatdhesim do të thotë se shteti (Irlanda) nuk do të kthejë askënd në vendin ku jeta ose liria e tyre mund të jetë në rrezik.

17. Çfarë ndodh nëse më akordohet Mbrojtja Ndërkombëtare?

Nëse ju akordohet mbrojtje ndërkombëtare (status refugjati ose mbrojtje shtesë) ose leje qëndrimi në përgjithësi juve ju lejohet të qëndroni në Irlandë.

Nëse juve ju akordohet status refugjati ose mbrojtje shtesë ju merrni një letër që ju jep informacion të detajuar mbi atë që duhet të bëni më pas si dhe të drejtat dhe detyrimet tuaja.

Nëse juve ju akordohet leje qëndrimi ju gjithashtu do të merrni një letër që ju mundëson informacion të detajuar mbi atë që duhet të bëni më pas si dhe gjithashtu të drejtat dhe detyrimet tuaja.

18. Çfarë ndodh nëse më refuzohet Mbrojtja Ndërkombëtare (status i refugjatit ose mbrojtja shtesë)?

Nëse ministri ju refuzon deklarin si refugjat ose për mbrojtje shtesë, ju keni të drejtë të apeloni rekomandimin te Gjykata e Apelit të Mbrojtjes Ndërkombëtare.

Nëse ministri ju refuzon deklarin si refugjat por vendos t'ju akordojë mbrojtje shtesë, ju keni të drejtë të apeloni refuzimin e statusit të refugjatit te Gjykata e Apelit të Mbrojtjes Ndërkombëtare.

Detajet e afateve për regjistrimin e apelit dhe informacionit përkatës do të përfshihen me rekomandimin e Zyrës së Mbrojtjes Ndërkombëtare.

Nëse lind kjo situatë TUSLA dhe Bordi i Ndhmës Ligjore do t'ju ndihmojnë me përgatitjen e apelit tuaj. TUSLA dhe Bordi i Ndhmës Ligjore do t'ju ndihmojnë gjatë gjithë procesit të mbrojtjes.

Nëse juve ju refuzohet mbrojtja ndërkombëtare pas apelit te Gjykata e Apelit të Mbrojtjes Ndërkombëtare dhe ministri mendon se nuk ka arsye të tjera përse juve duhet të lejoheni të qëndroni në Irlandë atëherë mund të mos ju lejohet më të qëndroni në Irlandë dhe duhet të diskutoni situatën tuaj me përfaqësuesin tuaj të TUSLA-s dhe konsulentët ligjorë.

Më shumë informacion rreth apeliave mundësohet në internet në www.protectionappeals.ie

19. Organizatat me të cilat hyn në kontakt

Gjatë procedurës së aplikimit për mbrojtje ndërkombëtare ju do të takoni njerëz nga organizata të ndryshme. Mund të lexoni çfarë bëjnë këto organizata më poshtë.

Shërbimi Irlandez i Natyralizimit dhe Imigracionit (INIS), Departamenti i Drejtësisë dhe Barazisë

INIS është përgjegjës për funksionet e Ministrit të Drejtësisë dhe Barazisë në lidhje me azilin, imigracionin (duke përfshirë vizat) si dhe çështjet e shtetësisë.

Faqja në internet: www.inis.gov.ie

Zyra e Mbrojtjes Ndërkombëtare

(IPO).

Funksioni kryesor i Zyrës së Mbrojtjes Ndërkombëtare së Shërbimit të Natyralizimit dhe Imigracionit është të hetohen aplikimet dhe të jepen rekomandime/vendime për llogari të Ministrit të Drejtësisë dhe Barazisë nëse një aplikant ka të drejtë për mbrojtje ndërkombëtare në Irlandë ose nëse një aplikant që nuk i akordohet, nëse ai apo ajo duhet (për arsye të tjera) të lejohet të qëndrojë në Irlandë. **Detajet e kontaktit në faqen 24**

Bordi i Ndhmës Ligjore (LAB).

Ju keni të drejtë të konsultoheni me një avokat dhe t'ju mundësohen shërbimet e Bordit të Ndhmës Ligjore. Bordi i Ndhmës Ligjore ofron shërbim ligjor konfidencial për personat që aplikojnë për mbrojtje në Irlandë. Bordi i Ndhmës Ligjore mundëson asistencë ligjore dhe konsulencë në mbështetje të aplikimit tuaj për mbrojtje.

Ata do t'ju ndihmojnë në plotësimin e pyetësorit për aplikimin për mbrojtje dhe arsyet e tjera për qëndrim në Irlandë. Ata gjithashtu do t'ju ndihmojnë në përgatitjen e intervistës tuaj kryesore dhe mund të bëjnë përfaqësime me shkrim te ministri në emrin tuaj për të mbështetur aplikimin tuaj.

Faqja në internet:

www.legalaidboard.ie

Numri i telefonit: 01-6469600

TUSLA - Agjencia e Fëmijës dhe Familjes



Njësia e Fëmijës Individual kujdeset për fëmijët që mbërrijnë pa prind ose kujdestar në Irlandë. Ata mund të kujdesen për nevojat imediate dhe në vazhdim të fëmijëve individualë që kërkojnë mbrojtje. Përgjegjësitë e TUSLA-s përfshijnë akomodimin, nevojat mjekësore dhe sociale, si dhe bërjen e aplikimeve për mbrojtje ndërkombëtare për llogari të fëmijës.

Faqja në internet:

www.tusla.ie

Numri i telefonit: 01-6477000

Gjykata e Apelit të Mbrojtjes Ndërkombëtare (IPAT).

Funksioni kryesor i Gjykatës së Apelit të Mbrojtjes Ndërkombëtare është shqyrtimi dhe vendimmarrja në apelimet kundër rekomandimit të Zyrës së Mbrojtjes Ndërkombëtare

Faqja në internet:

www.protectionappeals.ie

Numri i telefonit: 01-4748400

Komisionari i Lartë për Refugjatët i Kombeve të Bashkuara (UNHCR).

UNHCR mundëson udhëzim mbi ligjin dhe politikat për refugjatët dhe azilin në Irlandë. Zakonisht ata nuk bëjnë përfaqësime për azilkërkesit individualë, sidoqoftë, njësia e mbrojtjes mund të ofrojë asistencë në raste të veçanta në të cilat azilkërkesit, refugjatët dhe njerëzit pa shtetësi kanë nevojë për ndihmë urgjente ose të specializuar, mbështetje dhe konsulencë.

Ju ose përfaqësuesit tuaj ligjore mund ta kontaktoni këtë zyrë (UNHCR) nëse dëshironi ndihmë.

Adresa:

102 Pembroke Road,

Ballsbridge,

Dublin 4, Ireland

Email: Informacion i përgjithshëm: iredu@unhcr.org

Numri i telefonit: 01-6314510.



20. Më shumë informacion

Nëse keni pyetje të tjera rreth procesit të mbrojtjes mund të pyesni te TUSLA, përfaqësuesin tuaj ligjor në Bordin e Ndihmës Ligjore ose mund të kontaktoni me Zyrën e Mbrojtjes Ndërkombëtare. Gjithashtu mund t'i bëni pyetjet personalisht gjatë intervistës tuaj. Duhet të lexoni broshurën kryesore të informacionit të titulluar "Broshura e Informacionit për Aplikuesit për Mbrojtje Ndërkombëtare".

Zyra e Mbrojtjes Ndërkombëtare mund të kontaktohet në:
Telefon: 01-6028008 - nga e hëna deri të premten, 9:15 a.m.
deri në 4.30 p.m.

Faqja e internetit: www.ipo.gov.ie

E-mail: info@ipo.gov.ie

Letra: International Protection Office

79 - 83 Lower Mount Street

Dublin 2

Nëse dëshironi të bëni pyetje rreth zhvillimit të aplikimit tuaj duhet të keni këtë informacion:

Numrin e dosjes tuaj

Emrin tuaj të plotë

Procedura e ankimeve:

Nëse dëshironi të bëni ankesë rreth vonesave ose shërbimit të dobët të klientit në përpunimin e aplikimit tuaj, mund të kontaktoni punonjësin tonë të marrëdhënieve me klientët në

Customer Liaison Officer

International Protection Office

79-83 Lower Mount Street

Dublin 2

21. Numra telefoni dhe adresa email të rëndësishme

	
	
	
	
	